



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. 81 Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 21 / 06 / 2023

VENDIM
Nr.18, date 21 /06 /2023

PËR

MIRATIMIN E REGJISTRIT TE DIGAVE TE MEDHA PER VITIN 2022

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndertimin, Shfrytëzimin dhe Mirembajtjen e Digave dhe Dambave" si dhe të VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Për Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave", Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 21.06.2023 mori në shqyrtim rregjistrin e digave të mëdha të hartuar nga Keshilli Teknik i digave të medha (KTPD) për vitin 2022 duke u bazuar në rregjistrin e mëparshëm të vitit 2021, informacioneve të ardhura nga shfrytëzuesit e digave, projekteve të miratuara nga KKDM gjatë vitit 2022 si dhe kontrolleve të dokumentacionit teknik përkatës.

Pas diskutimeve të të gjithë antarëve të pranishëm, KKDM

VENDOSI:

- 1- Miratimin e Rregjistrit të 351 digave të medha për vitin 2022 me të dhenat kryesore teknike të digave dhe rezervuarëve të tyre sipas tabelës bashkelidhur. Rregjistri i 351 digave të medha me të dhenat kryesore teknike përkatëse të digave të medha sipas tabelës bashkelidhur duhet të botohet në faqen e internetit të KKDM.
- 2- SKDM të përgatitë arkiven e pasaportave të digave të medha të përcaktuara në këtë rregjister sipas udhëzimit të KKDM të miratuar me vendimin Nr. 08, datë 21.12.2020 deri në fund të vitit 2023. SKDM duhet të përgatitë një raport në lidhje me arkivimin dhe plotësimin e pasaportave të digave i cili duhet të dorëzohet pranë KKDM brenda vitit 2023.

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për zbatimin e këtij Vendimi në përputhje me legjislacionin në fuqi si dhe ndjekjen e detyrave dhe rekomandimeve të dhena në këtë vendim.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KRYETARI

Arjan JOVANI

